

**DHIMBJE E VLERËSIM
PËR NDARJEN E PARAKOHSHME NGA JETA
TË POETIT PASKAL RENDA**



Pasquale Renda (18.7.1955-29.10.2014)

Më 29 shtator, është ndarë së gjallësh **Paskal Renda**, poet dhe veprimtar arbëresh, por mbi të gjitha një mik i mirë dhe i shtrenjtë i imi dhe i të gjithë atyre që kanë pasur rastin të vizitojnë Horën e Arbëreshëve (*Piana degli Albanesi*) të Sicilisë.




Paskalin e kam njohur këtu e 31 vjet më parë, së pari, në të vitit 1983, kur vajta për anketime dialektologjike në Horë dhe, për disa ditë radhazi, Paskali, bashkë me miqtë e tjerë arbëreshë, si poetët **Zef Skiro di Modika**, **Zef Skiro Maji**, si dhe me shumë prej atyre që i kishim njohur më parë në Shqipëri në përbërje të grupeve të studentëve arbëreshë që vinin për kurse verore të gjuhës shqipe në Universitetin e Tiranës, si **Xhino (Giorgio) Ales**, **Rozeta Riolo**, **Zef e Rosana Vasoti**, **Pino e Pina Verga** etj.

Paskali ishte gjithmonë me ne, gjithmonë i gatshëm për të na njohur me veprimtarët e nismat kulturore të arbëreshëve të Horës. Paskali ishte djalë i ri dhe disi me ndrojtje më tregoi se shkruante edhe vjersha. Njërin prej tyre, të cilën ma dërgoi mbasi u ktheva nga ajo ekspeditë, meqë ishte edhe shumë e bukur dhe me freski tematike e pata botuar te gazeta "Drita", shoqëruar me disa rreshta përnjohës. Kjo ishte një nxitje për poetin e ri dhe, kur u takuam për herë të dytë, në dhjetor të vitit 1984, në Kongresin e Pakicave Etnike, të organizuar nga Instituti Albanologjik "R.Petrotta" dhe Katedra e shqipes e Universitetit të Palermos, të drejtura nga prof.Antonino Guzzetta, Paskali mezi po na priste. Grupi ynë ishte i përbërë nga shkrimtarët **Dritero Agolli** e **Nasho Jorgaqi** dhe nga dy gjuhëtarë: prof.**Androkli Kostallari** dhe unë. Në aeroportin e Palermos për të na pritur kishin dalë, të veshur me univformën e policisë, Paskali dhe një tjetër koleg i tij, Franko, që të dy arbëreshë dhe që të dy flisnin aq bukur gjuhën shqipe. Kjo ishte një befasi shumë e këndshme sidomos për Driteroin që shkonte për herë të parë në Piana, porse gjatë atyre ditëve që qëndruam në Piana, befasia do të zëvendësohej me realitein e bukur që **në Horën e arbëreshëve flitej kudo e kurdoherë shqip**. Shqip flisnin edhe pronarët e punonjësit që na shërbenin te Restarant "Montagnola", shqip fliste edhe kryetari i bashksë **Giacomon Cuccia**, të cilin Paskali dhe të tjerët e thërrisnin miqësisht me zbulimin **Xhakomin**; shqip flitej në të gjitha shtëpitë e miqve që na prisnin më bujarinë tradicionale të Horës, që nga mëma e Mateut (prof.**Matteo Madala**, atëherë student e mik i Paskalit, sot profesor titullar dhe emër i dalluar i studimeve alanologjike); shqip këndonte natë për natë te Bar Rotonda edhe **Nikolla Lo Jakono** dhe grupi tij "**Shqiponjat arbëreshe**"; shqip fliste krejt katundi, kur dilte në sheshin e Horës për të parë "kullumbin"(pëllumbin) në oborrin e kishës, që ishte jo larg nga shtëpia e Paskalit të ndjerë. Për një kohë më të gjatë në ngulimet arbëreshe të Sicilisë kam qëndruar në vitin 1988, kur, bashkë më dy kolegë gjuhëtarë (Mehmet Çeliku e Thoma Rrushi), ishim të ftuar nga Bashkia e Kuntisës (*Contessa Ettellina*) për të zhvilluar një kurs njëmuor të gjuhës shqipe me arsimtarë e veprimtarë kulturorë arbëreshë të atij ngulimi. Ne e kishim punën dhe qëndrimin në Kuntisë, që është rreth 60 km larg Pianës, por Paskali, herë vetëm, herë me Matteo Mandalain vinin e na gjenin dhe kemi kaluar ditë shumë të bukura, në shoqërinë e tyre dhe të mikpritësve të Kuntisës, sidomos nga organizatorët e kursit të shqipes: prof.**Giuseppina Cuccia Lo Jacono** dhe prof.**Guarina Tomasso in Cilluffo**, që bashkë me Pinon (**Giuseppe Ciluffo**) kishin organizuar një kurs shumë të frytshëm për gjuhën shqipe, si dhe na kanë mundësuar të kryenim edhe anketime e hulumtime gjuhësore shumë të vlefshme. Aso here kam plotësuar edhe një anketë të plotë dialektologjike në Kuntisë, duke pasur si informatore zonjën **Pia Skiro**, motrën e të shquarit prof.**Giuseppe Schiro Junior**.



Paskal Renda ka qenë kurdoherë shoqëruesi ynë i përzemërt, na ka ndihmuar të gjenim njerëzit e përshtatshëm për anketimet tona rreth gjuhës arbëreshe, na ka njohur me poetë e veprimtarë kulturorë arbëreshë dhe na ka pritur shumë herë për dreka e darka në shtëpinë e tij bujare, ku na priste nëna e tij, një zonjë tipike arbëreshe, gjithmonë e buzëqeshur dhe e ëmbël; kemi qenë edhe në shtëpinë e vëllezërve të tij: dr. **Sebastianit** e **Vitos**, që ishin më të mëdhenj se ai në moshë, por që për Paskalin kishin dobësi dhe bëheshin copash që të na gostitnin e të na kënaqnin.

Kam pasur edhe lëtrëkëmbim të gjatë me Paskalin, kam ndjekur edhe vjershat që ka botuar, sidomos vëllimin e tij me titullin “Shtegu”, *Poezi, Hora e t’arbëreshëve*: Mondo albanese, 1984, ku është përfshirë edhe vjersha e tij aq e bukur e plot dashuri për shqipërinë e shqiptarët “Dëshirë”.



“Kam dëshirë
të shtrëngoj duar të lodhura.
Kam dëshirë
të shoh sy plot shpresë.
Kam dëshirë
të puth një flamur gurgull me djersë.
Kam dëshirë
të dëgjoj si e këndojnë Lirinë
zogjtë shqiptarë.
Kam dëshirë
të shoh si rriten lulet,
potisur me djersët e të gjithë popullit.
Kam dëshirë
të përqafoj një vëlla.
Kam dëshirë
të përqafoj dhjetë...njëqind...
një mijë...tremiliona
vëllezër shqiptarë.”

Ti ike, Paskal, mik i shtrenjtë dhe i dashur, por mbeten kujtimet e bukura, mbeten letrat dhe vjershat e tua të sinqerta dhe emri yt fisnik.

Të qoftë i lehtë dheu i Horës tënde që e deshe aq shumë.

Gjovalin Shkurtaj